



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr. 176 dt.26.12.1995

**PER**  
**DHENIE SHITESH FONDESH PER DREJTORINE E**  
**QENDRES EKONOMIKE TE CERDHEVE TE FEMIJEVE**

Këshilli i Bashkisë së Tiranës, pasi analizoi relacionin e paraqitur nga Seksioni i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtoria e Financës lidhur me nevojat e ngutshme për fonde për Drejtorinë e Qendrës Ekonomike të Çerdheve të Fëmijëve si dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.673, dt.29.11.1995

Vëren se :

Gjendja financiare e Drejtorisë së Qendrës Ekonomike të Çerdheve është jo e mirë, pasi ajo ka pa likujduar Drejtorinë e Ndërmarrjes Tregtare të Mencave për muajin tetor, nëntor 2.200.000 lekë, Ndërmarrjen e Lëndës Djegëse për muajin shtator, tetor, nëntor 750.000 lekë si dhe ka nevojë për shtesë në fondin e veçantë : 770.000 lekë

**VENDOSI**

1. Ti japë Drejtorisë së Qendrës Ekonomike të Çerdheve fondet si më poshtë :

1.Fonde për ushqimin e fëmijëve 2.200.000 lekë.

2.Fonde për dru zjarri 750.000 lekë

3.Shtesë për fondin e vveçantë 770.000 lekë

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Seksioni Shëndetësisë dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Drejtoria Administrimit Financiar si dhe Drejtoria e Qendrës Ekonomike të Çerdheve.

**KRYETARI**

**BESNIK PETRELA**